



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 2, datë 20.01.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.3, 5, 7 RRUGA “BASHKIMI”, PALLATI NR.1, RRUGA “DEMOKRACIA”, PALLATI NR.2/1, RRUGA “PROGRESIT”, PALLATI NR.6, RRUGA “MILENIUMI” DHE PALLATI NR.4, RRUGA “MINIERËS” NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr.164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit nr. 471/7 prot., datë 14.01.2022 si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Aneksin 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr.3, 5, 7, rruga “Bashkimi”, Pallati nr.1, rruga “Demokracia”, Pallati nr.2/1, rruga “Progresit”, Pallati nr.6, rruga “Mileniumi” dhe Pallati nr.4, rruga “Minierës” në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar.
2. Miratimin e disa shtesave të subjekteve përfituese në Aneksin nr.1 “Subjektet përfituese të pallateve në Njësinë Administrative Manëz” të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 28.06.2021, sipas tabelës si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
73	ARJAN SALIAJ	6 (3+3)	3+1
74	PETRIT SALIAJ	5	3+1
75	YLLI XHAKO	3	2+1
76	FLORIKA DEMA	3	2+1
77	HATIJE KOLECI	7(4+3)	3+1
78	SHEFQET CURUMI	2	1+1
79	MERITA MUSABELLIU	1	1+1
80	FESTIM MEDINI	4	2+1
81	RAMAZAN MULLAHI	4	2+1
82	SABRI VOGLI	2	1+1
83	AVNI HYSENI	4	2+1
84	KARAFIL NELI	4	2+1
85	SINON HOXHA	3	2+1
86	AGUSTIN KOLECI	4	2+1
87	LINDITA KOPSHTI	5	3+1
88	ARBEN TURJA	4	2+1
89	LENA SHESHI	1	1+1
90	BEHIJE ALLÇI	3	2+1
91	GJYSLYKO RRAPOLLARI	9 (1+8)	3+1
92	SHPËTIM RRAPOLLARI	4	2+1
93	NAIM LLESHI	3	2+1
94	SAMI HOXHA	3	2+1

95	FATMIR KAJMAKU	4	2+1
96	GËZIM KAJMAKU	5	3+1
97	SHKURTE ALLÇI	4	2+1

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



### KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 20.01.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Nr. 45/prot.  
1

27.01.22 585/2  
Durrës, më 26.01.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK** ✓  
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.2 datë 20.01.2022 “Për miratimin e disa shtesave në Aneksin 1, të VKB Nr 77 datë 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 3,5,7 Rruga “Bashkimi” Pallati nr 1 Rruga Demokracia, Pallati nr 2/1, Rruga “Progresit” Pallati Nr 6 Rruga “Mileniumi” dhe pallati nr 4 Rruga “Minierës” në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”, i ndryshuar.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

*R. Nasto*

